



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:243147

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05841781

**AC-I-23-0221**

**Në ankesën e**

***Paditësi/ankuesi***

**J B** fshati B, Podujevë, përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

**Kundër**

***E paditura***

**N.SH "FAN "Zahir Pajaziti", Podujevë (në Likuidim)** e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-4031 të datës 31 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 20 qershor 2024, me shumicë lëshon këtë:

## **A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së C-IV-14-4031 i datës 31 mars 2023 dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0450 i datës 14 prill 2014.**

- 3. Obligohet e paditura AKP që paditësit në emër të kompensimit për 3 paga të papaguara, ti paguaj shumen prej 660.00 euro, në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 66.00 euro, dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, të gjitha sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 15 maj 2022, paditësi parashtroj ankesë në DHPGJS, me të cilën e kundërshton vendimin e AL PRN046-0450, të datës 14 prill 2014, Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ( më tej Autoriteti i likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin për tre paga të pa paguara, në shumë prej 660.00 euro NSH FAN' Zahir Pajaziti" ( në likuidim), me arsyetimin se kërkesa duhet të mbështet në prova dhe si e tillë kërkesa është parashkruar komfor nenit 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar.

Paditësi pohoi se arsyetimi të cilin e ka dhënë AL për refuzimin e kërkesës është i kundërligjshëm dhe i pa bazë. Po ashtu paditësi ka pohuar se kërkesa e paraqitur për pagesë pranë AL nuk është parashkruar. Në mbështetje të kërkesës paditësi ka bashkangjitur dokumentet në kopje si: autorizimin dhe vendimin e kundërshtuar të AL-së.

Me 22 mars 2023, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AKP-së. AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja ka pohuar se paditësi ka dështuar të tregoi se cila dispozitë ligjore është shkelur me Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohon se kërkesa për kompensim e tri pagave është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi ka dështuar të paraqet prova në gjykatë se ai i ka kërkuar këto paga brenda 3 viteve në Gjykatën kompetente. Prandaj nga këto arsye me të drejt

Autoriteti i Likuidimit e kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompensimin e këtyre pagave.

Me 31 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-4031, e ka ankesën e paditësit e ka refuzuar si të bazuar, dhe e ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0450 të datës 14 prill 2014, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj. Shkalla e I-rë ka konstatuar se parashkrimi për kompensimin për 3 paga të pa paguara në shumë prej 660.00 euro i kërkuar në këtë lende ishte rregulluar me LMD -në (1978), i cili ishte Ligji ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD tani në fuqi ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh. Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta kërkit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të këtë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qofte se me Ligj për rastet e veqanta nuk është parashikuar diçka tjetër.

Në rastin konkret drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për 3 paga të pa paguar është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndalur rrjedhën e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës, paditësi kërkesën e ka parashtruar lidhur me 3 pagat e pa paguara të gjitha në shumë në shumë prej 660.00 euro. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi kërkesën për 3 pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 26 shtator 2013, brenda afatit për parashtrimin e kërkesave pranë AL-së, por që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë vetëm sa ishte parashkruar.

Shkalla e I-rë kishte konstatuar se paditësi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të pretenduar në kohën kur nuk i janë paguar pagat përkatësisht në kohën kur ka ofruar shërbime për NSH-në, kështu që afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë menjëherë pasi ka lindur e drejta e kërkesës, pra afati i parashkrimit ka arritur në muajin prill të vitit 2009, paditësi kërkesën e ka parashtruar në muajin shtator 2013, që do të thotë jashtë çdo afati afati te parapar ligjorë. Paditësi me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike,

sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Me 14 prill 2023, e paditësi nëpërmjet përfaqësuesit e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-4031 të datës 31 mars 2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të priset Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim tek gjyqtari individual, apo ta detyroj të paditurën që në emër të kompensimit të tri pagave të pa paguara ti kompensojë paditësit shumën prej 660.00 euro, si dhe të detyrohet e paditura që të i kompensojë paditësit kamatën, po ashtu të detyrohet e paditura që ta bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odes së Avokateve.

Paditësi ka shtuar se në mars të vitit 2006 mbi 345 punëtorët e FAN-it pranuan letër pezullimet nga AKM-ja, njoftimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës dhe më tutje në këtë njoftim thuhet se: "Shumat- pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontakoheni kur të fillojnë këto procedura". Paditësi/ankuesi në ankese ka theksuar se i është përmbajtur udhëzimeve të njoftimit të AKM-së dhe kur ka filluar procesi i likuidimit brenda aftit të paraparë ligjore ai i a parashtruar kërkesat e tij, pra nuk mund të flitet për parashkrim. Ankuesi thekson se i janë njohur pagat dhe dokumentet të shkruar dhe të sqaruar për secilin muaj në shuma specifike dhe menaxhmenti i NSH-së këto vendime dhe këtë dokumentacion i ka përcjellë të Autoriteti i Likuidimit të kësaj NSH-je.

Po ashtu paditësi/ankuesi sa i përket kërkesës lidhur me kompensimin e tri (3) pagave për muajt janar, shkurt dhe mars 2006, Menxahmenti i NSH-së e ka bërë llogaritjen e tri (3) pagave ashtu siç parasheh ligji dhe pagat të cilat janë mbetur borxh paditësit/ankuesit i janë njohur me dokument të shkruar dhe të sqaruar për secilin muaj në shuma specifike dhe atë përkatësisht në shumën e plote prej 660.00, siç vërehet nga dokumenti i lëshuar nga shërbimi financiar i NSH FAN "Zahir Pajaziti" i nënshkruar nga drejtori i NSH-së i vulosur dhe i protokolluar nga personeli zyrtar i NSH-së. Ankuesi thekson se kjo njohje fare nuk është komentuar fare nga AL-ja. Paditësi ankesës i ka bashkangjitur Librezën e punës, njoftimin për

ndërprerjen e marrëdhënies së punës dt. 24 mars 2006, pranim njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në NSH.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit . Në këtë parashtrësë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditëses duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesa si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 26 shtator 2013, e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar kompensimin për tre paga të pa paguara në shumën prej 660.00 euro nga NSH FAN "Zahir Pajaziti" Podujevë, mirëpo kërkesa e tij nga AL me vendimin PRN046-0450 të datës 14 prill 2014, ishte refuzuara si e pavlefshëm me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Më 31 mars 2023, Shkalla e parë e DHPGJS ka marrë Aktgjykim me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditëses si të pa bazuar dhe ka vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0450 të datës 14 prill 2014, si i drejtë dhe të bazuar në Ligj. Shkalla e parë kërkesën e paditëses e ka refuzuara për shkak të parashkrimit. Tutje

ka arsyetuar se me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta kërkimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të këtë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qofte se me Ligj për rastet e veqanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Tutje kishte konstatuar se afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë menjëherë pasi ka lindur e drejta e kërkesës, pra afati i parashkrimit ka arritur në muajin prill të vitit 2009, paditësi kërkesën e ka parashtruar në muajin shtator 2013, që do të thotë jashtë çdo afati afti të paraparë ligjorë.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi kishte parashtruar ankesë dhe tutje pretendon se asaj i takojnë tre paga e fundit të papaguara.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e saj të dorëzuar në Shkallën e I-rë e kishte bashkangjitur vendimin e kundërshtuar të AL dhe autorizimin për përfaqësim.

Në këtë lëndë duhet vlerësuar nëse paditësi me provat e ofruara ka dëshmuar se atij i takojnë 3 pagat e fundit të papaguara dhe se a ka pasur ndërprerje të parashkrimit të kërkesës për paga.

Paditësi në ankesën e tij ka pretenduar se ka punuar në NSH FAN "Zahir Pajaziti" Podujevë deri në privatizimin e NSH-së me datë 24 mars 2006 dhe se kërkesa e tij për 3 paga nuk është parashkruar. Pranë shkallës së I-rë paditësi nuk kishte paraqitur të gjitha provat, mirëpo këto pretendime ajo i ka mbështetur me dëshmitë e sjella pranë Kolegjit të Apelit si: Librezën e punës, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dt. 24 mars 2006, pranim njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në NSH.

Kolegji i Apelit me qëllim të arritjes së drejtësisë në bazë të nenit 70 i LPDH i pranon provat e paraqitura para tij dhe pas vlerësimit të provave, përkatësisht njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dt. 24 mars 2006, Librezës së punës, dhe pranim njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në NSH, vjen në përfundim se paditësi ka qenë punëtor deri më 24 mars 2006, në ditën e privatizimit të NSH-së.

Kolegji i Apelit vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi ishte një punëtor i NSH FAN "Zahir Pajaziti" Podujevë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së paditësit për kompensim për pagat e papaguara.

Kolegji i Apelit vlerëson se pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit është parashkruar, nuk është i saktë. Kolegji vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me njoftimin e datës 24 mars 2006 dhe kështu pretendimi i të paditurës, se kërkesa është parashkruar nuk është i drejtë dhe nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore. Me njoftimin për ndërprerjen e punësimit paditësi ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrojë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH-së.

Paditësi pretendon se asaj i takojnë tre paga e fundit të papaguara. E paditura nuk e ka dëshmuar të kundërtën me prova, përkatësisht nuk ka dëshmuar me asnjë provë se paditësit i ka përmbushur obligimin e tij për tre pagat e papaguara. Në këtë rast e paditura e ka barrën e dëshmisë për ta provuara të kundërtën meqë ajo i mban edhe dokumentet e NSH-së dhe ka listë pagesën e pagave për punëtorët e NSH-së.

Në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në interes ligjor prej 10%, në shumë prej 66.00 euro, ndërsa në bazë të nenit 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të Avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, aprovohet ankesa e paditësit si bazuar, ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si dhe Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **Taksat gjyqësore**

Kolegji i Apelit nuk cakton taksa gjyqësore për ankuesin. Udhëzimi Administrativ Nr.01/2007 për unifikimin e taksave gjyqësore, në nenin 13.3, parasheh që punëtorët për pagat e papaguara lirohen nga pagimi i taksave gjyqësore për shumat e kërkesave deri në 1000 €. Lartësia e kërkesës së ankuesit ishte nën 1000 €, prandaj ankuesi lirohet nga taksa.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 20 qershor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_